# ST. NICHOLAS ALBANIAN ORTHODOX CHURCH

## SHRINE OF THE HOLY VIRGIN MARY



2701 N. NARRAGANSETT AVE., CHICAGO, IL 60639

773-889-4282 † stnicholasalbanianchicago.org

# Schedule of services † Programi i Shërbesave

**-January 1, Wednesday: Circumsion of Christ- St. Basil the Great**
**Rrethprerja e Krishtit- Shën Vasili i Madh**

**9:00 a.m.** Orthros and Divine Liturgy
Mëngjesore dhe Meshë Hyjnore

**-January 5, Sunday before Theophany**
**E Djela para Theofanisë**

**9:00 a.m.** Orthros - Divine Liturgy and Holy Water
Mëngjesore - Meshë Hyjnore dhe Uji i Bekuar

**-January 6, Monday: Holy Theophany**
**Theofania E Shenjtë**

**9:00 a.m.** Orthros - Divine Liturgy and Holy Water
Mëngjesore - Meshë Hyjnore dhe Uji i Bekuar

**-January 7, Tuesday: St. John the Baptist**
**Shën Joan Pagëzori**

**9:00 a.m.** Orthros and Divine Liturgy
Mëngjesore dhe Meshë Hyjnore

**-January 12, Sunday after Theophany**
**E Djela mbas Theofanisë**

**9:00 a.m.** Orthros and Divine Liturgy
Mëngjesore dhe Meshë Hyjnore

**-January 17, Friday: St. Anthony the Great**
**Shën Antoni i Madh**

**9:00 a.m.** Orthros and Divine Liturgy
Mëngjesore dhe Meshë Hyjnore

-January 18, Saturday: St. Athanasios the Great

Shën Athanasi i Madh

**9:00 a.m.** Orthros and Divine Liturgy

Mëngjesore dhe Meshë Hyjnore

-January 19, Sunday: St. Mark of Ephesus

Shën Marku i Efesit

**9:00 a.m.** Orthros and Divine Liturgy

Mëngjesore dhe Meshë Hyjnore

-January 20, Monday: St. Euthymius the Great

Shën Efthimi i Madh

**9:00 a.m.** Orthros and Divine Liturgy

Mëngjesore dhe Meshë Hyjnore

-January 26, Sunday: St. Xenophon

Shën Ksenofonti

**9:00 a.m.** Orthros and Divine Liturgy

Mëngjesore dhe Meshë Hyjnore

-January 30, Thursday: The Three Hierarchs

Tre Hierarket

**9:00 a.m.** Orthros and Divine Liturgy

Mëngjesore dhe Meshë Hyjnore

# Merry Christmas



## Christmas 2024

Dear Brothers and Sisters, blessed of the Lord

"The universe today is filled with joy! Christ is born of the Virgin." Joy

This is the message of today's feast. Joy for the birth of Christ, joy for the presence of the Light, the Sun of righteousness, among us. "Our Savior has visited us from on high" .Here, now, Christ is born and nothing is the same anymore. Close your ears to the voices that bring turmoil and confusion. The humble cave of Bethlehem overturns all logic and dispels the dark plans of the powerful on earth who want to dominate the lives of people. This is not a false consolation nor a simple symbolism.

Today's feast proclaims something inconceivable by the human mind: God has come to dwell with us. He came to unite with humanity, to share its pain, to respond to the longing for redemption. The inconceivable, inaccessible and uncreated God humbles himself and becomes one with our perishable and mortal nature. Really, not imaginary. The divinity empties itself into the body of humanity out of love alone. A scandal to reason, an incomprehensible madness. God becomes man in order to make man, by grace, a god.

Jesus is born and works out the salvation of the world in an unusual way. With his silent coming into the world, with the manger, with the Cross. Unlike modern leaders, who advertise power, noise and arrogance. If for the logic of the world, glory and power is being able to impress, scare, oppress the other and ultimately weaken him, in the spirit of the gospel, the fellow man stands before you as the image of the incarnate God. For the Christian, there is no superior or inferior. Discrimination is abolished, unity prevails: "there is neither Jew nor Greek, there is neither slave nor free, there is neither male nor female, we are all one in Christ Jesus." Unfortunately, there are many who cannot stand the idea of a god who takes the form of a slave and appears before us fragile, unprotected and despised, which is why they easily follow the various messiahs who appear from time to time, sowing in the world their sick messianism, full of arrogance, conceit and selfishness. All of them cannot conceive that the new path determined by the incarnate divine Word for the re-creation of man has nothing to do with the display of greatness and power, on the contrary, it begins with humiliation and emptying and ends at the cross. The path that the celebration of Christmas opens up for us is indeed difficult.

As Christians, we are called to assume our responsibilities. To become carriers of the peaceful revolution of humiliation and sacrificial love. To emerge from the dark caves of individualism and isolation into the splendor of the manger, where the light of salvation is diffused. To try to love as God loves us, with a love that takes bold initiatives, that knows no boundaries, that does not divide but unites and embraces everything. To the various challenges of today, let us oppose the dynamics of love and cultivate the peace that heaven proclaimed on the holy night of Christmas. With this love, perhaps we too can become little light bearers, devoutly carrying into the darkness of universal suffering the light of hope, which has a name and is called Emmanuel.

My brothers, do not be afraid of the voices that spread unrest and fear, do not listen to them no matter how loud they are. Tonight, listen to the voice of heaven that speaks again through the mouth of the poet: "Brothers, in peace the whole world breathes widely with all our dreams. Join hands, my brothers, this is peace, this is love, this is Christ." (Giannis Ritsos). Christ is born, joy to the world.

With blessings and love in born Christ

**†Archimandrite Ignatios Kruja**

# Happy New Year

# Krishtlindje të Bekuar



## Krishtlindje 2024

Të dashur vëllezër e motra të bekuar në Zotin

"Universi mbushet me gëzim sot! Krishti u lind prej Virgjëreshës" Gëzim

Ky është mesazhi i festës së sotme. Gëzim për lindjen e Krishtit, gëzim për Dritën, Diellin e drejtësisë mes nesh. "Shpëtimtari ynë na ka vizituar që lartazi". Këtu, tani, Krishti u lind dhe asgjë nuk është si më parë. Mbyllni veshët ndaj zërave që sjellin shqetësim dhe konfuzion. Shpella e thjeshtë në Bethlehem përmbys çdo llogjikë dhe prish planet e errëta të të fuqishmëve të kësaj bote që duan të dominojnë jetët e njerëzve. Ky nuk është një ngushëllim i rremë apo thjesht një alegori.

Festa e sotme shpall diçka të paimagjinueshme nga mendja njerëzore: Perëndia ka ardhur të banojë me ne. Ai erdhi të bashkohet me njerëzimin, të marrë pjesë në dhimbjen e tij, ti përgjigjet dëshirës për shpëtim. Perëndia që nuk mund të kuptohet, i pakrijuar, i paafrueshëm, përul veten e Tij dhe bëhet njësh me nayrën tonë të vdekshme. Realisht, jo diçka e imagjinuar. Hyjnia e zbraz veten e Tij në trupin e njerëzimit thjesht nga dashuria. Një skandal për arsyen, një marrëzi e pakuptueshme. Perëndia bëhet njeri që të bëjë njeriun perëndi me hirin e Tij.

Jezusi lind dhe shpëton botën në një mënyrë të pazakontë. Me ardhjen e heshtur në botë, me grazhdin, me Kryqin. Aspak si liderët modernë që reklamojnë pushtetin, zhurmën dhe arrogancën. Nëse për llogjikën e botës, lavdia dhe pushteti është të jesh në gjendje të shtypësh, frikësosh dhe të mundësh tjetrin, në frymën e ungjillit, bashkënjeriu qëndron para teje si ikonë e Perëndisë së mishëruar. Për të Krishterin nuk ka inferiorë dhe superiorë. Diskriminimi zhduket dhe uniteti mbizotëron: "nuk ka Jude apo Grek, nuk ka skllav apo të lirë, nuk ka burrë apo grua, jemi të gjithë një në Krishtin Jesus." Fatkeqësisht ka shumë që nuk e durojnë dot idenë e një perëndie që merr formën e një skllavi dhe na paraqitet i brishtë, i pambrojtur dhe i përbuzur. Prandaj ata ndjekin mesiat e ndryshëm që shfaqen here pas here, duke mbjellë në botë mesianizmin e tyre të sëmurë, të mbushur me arrogancë, mendjemadhësi dhe egoizëm. Të gjithë ata nuk mund të kuptojnë se udha e re, e përcaktuar nga Fjala hyjnore e mishëruar, për rikrijimin e njeriut, nuk ka asgjë të përbashkët me shpalosjen e pushtetit dhe madhështisë, por përkundrazi, fillon me përulësi dhe përfundon në kryq. Udha që çelet para nesh me festimin e Krishtlindjes është me të vërtetë e vështirë.

Si të Krishterë ne jemi të thirrur të marrim përsipër përgjegjësitë tona. Të bëhemi mbartës të revolucionit paqësor të përulësisë dhe dashurisë vetë-sakrifikuese. Të dalim prej skutave të errëta të individualizmit dhe izolimit, në shkëlqimin e grazhdit ku shpërthen drita e shpëtimit. Të përpiqemi të duam siç na do Perëndia ne, me një dashuri që merr iniciativa të guximshme, që nuk njeh kufij, që nuk përçan por bashkon dhe përqafon gjithçka. Sfidave që na shfaqen sot, le ti përballim dinamikat e dashurisë dhe të kultivojmë paqen që qiejtë shpallën në natën e shenjtë të Krishtlindjes. Të pajisur me këtë dashuri, ndoshta edhe ne mund të bëhemi pishtarë të vegjël, që me devotshmëri sjellim dritën e shpresës në errësirën e vuajtjes së përgjithshme, dritën që ka emrin Imanuel.

Vëllezër, mos u frikësoni nga zërat që përhapin shqetësim dhe frikë, mos i dëgjoni pavarësisht sa të zhurmshëm janë. Sot dëgjoni zërin e qiellit që flet sërish nëpërmjet gojës së poetit: "Vëllezër, në paqe bota mbushet me frymë me gjithë ëndërrat tona. Bashkohuni vëllezër, kjo është paqe, kjo është dashuri, ky është Krishti." (Giannis Ritsos). Krishti u lind, gëzim për botën.

Me bekime e dashuri në Krishtin e lindur

**†Archimandrite Ignatios Kruja**

## Gëzuar Vitin e Ri

# NOTICES

## DID YOU KNOW?




Prompt payment of your Church dues and donations help us maintain our beautiful, historic Church. Without you, there would not be any St. Nicholas. Won't you please consider donating while paying your dues online?

You may now donate to St. Nicholas Church by visiting our website: stnicholasalbanianchicago.org. Simply click on the DONATE button towards the bottom of the home page on our website and follow the directions. *Please note when using the DONATE button for memberships, you must scroll down and check the "Cover Fees" box, so the church receives the entire membership dues amount. You may also mail a check to the church or stop by the church office in person AFTER Liturgy.

PLEASE NOTE: The office is CLOSED during Orthros and Divine Liturgy. ANNUAL DUES

Do you have a suggestion, a comment, a question, or concern? We have established a new email for your use to express any concerns, ask a question or just make a comment.

It is: talktous@stnicholasalbanianchicago.org. This is aconfidential mailbox and will be monitored very closely to be sure all confidentiality are maintained.

## BRICK PROGRAM

Donations for our Commemorative Brick Program are still being taken. Bricks can be made to honor a memory, mark a special occasion or to show support. A 4 inch by 8 inch brick with up to 3 lines of engraving can be ordered for a donation of $250.00. Forms can be found at the candle stand or you may also request a form be sent to you via email or US mail. To ensure the wording and spelling are printed correctly on the brick, a form must accompany payment.



# ASK FATHER

A NEW DROP BOX IS LOCATED NEXT TO THE BULLETIN BOARD BY THE STAIRS



WRITE YOUR QUESTION TO
FATHER IGNATIOS AND DROP IT IN THE
BOX OR CONTACT DIRECTLY TO HIS EMAIL
priest@stnicholasalbanianchicago.org

# MEMBERSHIP-STEWARDCHIP




***2025 Memberships-Stewardship***

*Please send in or drop off your dues for* ***2025*** *and* ***2024*** *if you still have not done it;* ***$150*** *per individual over 21 years or old,* ***$250*** *for family membership-stewardship covering both husband and wife plus children under 21 yrs of age. Please note "2025 dues" on your check.*

*If you are not yet a member but would like to join our parish, please speak to a member of the Parish Council for information. There is no initiation membership-stewardship fee any more.*

***Member directory****-If you need to update or correct your address or phone number or the next membership-stewardship directory, please contact our church at* ***773-889-4282*** *or church@stnicholasalbanianchicago.org . You can also contact Maria Barbachi if you ant to give us your e-mail address to receive communication from our church. Also, if you are moving, please inform the church in regards to the forwarding address for future church communication. Membership-stewardship payment now can be done on our church website under donate button. The droop down list has "Membership-Stewardship" option you can use and make membership-stewardship payments.*

*Ju lutemi sillni ose dergoni pagesen e anetaresise-kujdestarise se Kishes per vitin* ***2025*** *dhe* ***2024*** *ne rast se nuk e keni bere akoma. Ajo eshte* ***$150*** *per personat mbi 21 vjec dhe* ***$250*** *per familjet qe mbulon burrin, gruan si dhe femijet e tyre ne moshen nen 21 vjec. Ju lutem shenoni "2025 dues" ne cekun tuaj.*

*Ne rast se ju nuk jeni anetar-kuhdestar i kishes dhe deshironi te beheni, kontaktoni zyren e kishes apo nje nga anetaret e Keshillit te Kishes per informacionin e duhur.*

*Ju lutem njoftoni Kishen ne rast se keni ndryshuar adresen e banimit apo numrin e telefonit per te bere korrigjimet e duhura ne listat e Kishes.* ***773-889-4282*** *ose church@stnicholasalbanianchicago.org*

# LINKS

https://stnicholasalbanianchicago.org/




https://www.facebook.com/stnicholasalbanianorthodoxchurch/photos




http://albaniandiocese-ep.org/



https://orthodoxalbania.org/



https://www.goarch.org/

